

ANTARESIMET E BASHKPUNIT ME SHOQATA E PROJEKTE TE KESHILLIT BASHKIAK KLOS

Këshilli Bashkiak Klos është i përbërë nga 21 anëtare mes të cilëve edhe 5 gra keshilltare.

Gratë keshilltare bëjnë pjesë në ALEANCEN E ZGJERUAR TE GRAVE
KESHILLTARE Klos që është pjesë e Aleancën e Kombëtare të keshilltarëve .

Aleanca e grave keshilltare luan një rol kyç për të siguruar gjithpërfshirjen sociale. Gratë synojnë barazi gjinore kjo tashmë e ka shtuar edhe kërkesën e konkurrencës. Gratë keshilltare e përceptojnë si përgjesi të tyre përfaqësimin e interesave të grave dhe vajzave në këshillin bashkiak, e këtë detyrë e kanë marrë dhe po e mbajnë me rigozitet anëtarët e këshillit Bashkiak Klos zonjat e keshilltare , të cilave ju mbetet punë e detyra për të bërë jo vetëm gjatë mandatit por edhe në vazhdimsi.

Këshilli Bashkiak Klos është i anëtarësuar edhe në shoqatën e Qarqeve e cila është një organizatë jopolitike , jofitimprurëse. Kjo shoqatë është anëtare e këshillit konsultativ të Qeverisjes Qëndrore/ Vetëqeverisjen Vendore strukturë kjo që siguron konsultimin e diskutimin e gjërë të nismave ligjore të qeverisë qendrore me organet e vetëqeverisjes vendore. Kjo shoqatë është bashkim vullnetar i pavarur i të gjitha Këshillave të Qarqeve të Republikës së Shqipërisë si subjekte juridike publike dhe cdo të zgjedhurit në këto këshilla.

Këshilli Bashkiak Klos bashkëpunon me shumë donatorë ku kryesori është projekti Zvicëran Bashki të Forta e cila ndjek strategjitë dhe politikat kombëtare zyrtare të zhvillimit duke punuar së bashku me administratën vendore dhe qeverisjen qendrore. Ky projekt ka mbështetur 61 bashkitë e vendit, këshillin Bashkiak në përmisimin e shërbimeve dhe rritjen e orientimit të menaxhimit, hartimin e rregulloreve si dhe asistencë në zbatimin e tyre duke i bërë ato me të zbatueshme e transparente, me një faqe webi sa më të pasur me informacione për qytetarët ashtu sic është edhe synimi i këtij projekti për Shqipërinë të përfitojnë në nivel vendor nga bashkitë e orientuara drejtë qytetarëve.

Këshilli Bashkiak është paisur me regjistra për : 1. kërkesa , ankesa , vërejtje,2. Regjistër për konsultimet me publikun 3. Regjistër për pedicionet të cilat qytetarët i gjejnë lehtësishtë në faqen e këshillit bashkiak pa qenë nevoja të shkojnë në zyrë për të

verefikuar kërkesën e tyre .4. Regjistri elektronik I mbledhjeve të këshillit si dhe I projekt akteve.

Transparente janë edhe Vendimet e Këshillit Bashkiak të cilat gjenden ne seksionin e vendimeve .